



**PROGRAM ORIENTUES PËR PROVIMIN
E MATURËS SHETËRORE PROFESIONALE 2015**

TEORIA PROFESIONALE E INTEGRUAR:

DREJTIMI MËSIMOR “SHËRBIME MJETESH TRANSPORTI”

Janar, 2015

1. Udhëzime të përgjithshme

Ky program orientues ndihmon në përgatitjen e nxënësve të drejtimit “**Shërbime mjetesh transporti**”, me strukturë 2+1+1, për provimin me zgjedhje të detyruar “Teori profesionale e integruar” të Maturës Shtetërore Profesionale 2015. Ai synon orientimin e përgatitjes së nxënësve nëpërmjet përqendrimit në njohuritë dhe aftësitë më të rëndësishme të lëndëve teorike profesionale. Njëherazi, ndihmon edhe në verifikimin paraprak të përgatitjes përfundimtare të nxënësve sepse mundëson zhvillimin e testeve përmbljedhëse. Programi orientues për provimin e “Teorisë profesionale të integruar” bazohet në:

- programet orientuese për Provimet Përfundimtare në: drejtimin “Shërbime mjetesh transporti”, Niveli I; në profilin “Shërbime motorike”, Niveli II, “Shërbime xhenerike”, Niveli II dhe profilin “Shërbime elektroauto”, Niveli II;
- programet e lëndëve teorike profesionale të drejtimit “Shërbime mjetesh transporti”, Niveli III (klasa e 13-të);
- Udhëzimin e përbashkët të MAS dhe MMSR nr. 2, datë 06.02.2015 “Për zhvillimin e provimeve të Maturës Shtetërore Profesionale 2015 në Republikën e Shqipërisë”.
- Rregulloren e Maturës Shtetërore 2015 në Republikën e Shqipërisë, miratuar me Urdhërin e Ministrit nr.61, datë 10.02.2015.”.

Në të përfshihen njohuritë dhe aftësitë më të rëndësishme të këtyre programeve. Për Bazat e sipërmarrjes, janë marë parasysh vetëm njohuritë e reja dhe jo veprimtaritë praktike.

2. Udhëzime për zbatimin e programit

Ky program duhet shqyrtuar me kujdes sepse evidenton dhe përforcon njohuritë teorike, por dhe aftësitë e nxënësve për aplikimin e njohurive në situata të njohura e të reja, analizën dhe vlerësimin e këtyre situatave. Specialistët e përfshirë në hartimin e bankës së pyetjeve dhe tezës së provimit të kësaj lënde, nuk duhet të përfshijnë për vlerësim tema mësimore që nuk janë parashikuar në këtë program. Përgatitja e nxënësve për provim të bëhet në mënyrë të vazhdueshme dhe duke përdorur një larmi metodash dhe mjetesh.

Gjatë punës për përgatitjen e nxënësve për provimin me zgjedhje të detyruar “Teori profesionale të integruar” të Maturës Shtetërore Profesionale, është e rëndësishme që herë pas here mësuesi të zhvillojë teste të nxënësve të tij, me teste që mund t’i hartojë vetë duke u bazuar në modelet e mëparshme të testeve të Maturës Shtetërore për teorinë profesionale.

Testi për drejtimin mësimor “**Shërbime mjetesh transporti**” do të ndërtohet në mënyrë të tillë ku të jenë të përfshira të tri nivelet e vështirësisë: niveli bazë, niveli mesatar dhe niveli i lartë. Njëkohësisht, edhe shpërndarja e pikëve në test do të jetë në varësi të

përqindjeve që zë çdo nivel. Gjatë hartimit të njësive të testit duhet të mbahen parasysh synimet e përgjithshme, në skeletkurrikulat përkatëse, të temave të përzgjedhura në këtë program.

Nxënësit duhet të kenë parasysh se lënda, e cila ka peshën më të madhe në këtë program orientues të Maturës Shtetërore Profesionale, në test do të përfaqësohet nga një numër më i madh pyetjesh.

3. Lëndët dhe temat përkatëse

Në programin orientues të provimit të “**Teorisë profesionale të integruar**” në kuadrin e provimit me zgjedhje të detyruar “Teori profesionale e integruar”, të Maturës Shtetërore Profesionale, për drejtimin mësimor “**Shërbime mjetesh transporti**”, do të përfshihen programet e lëndëve profesionale të mëposhtëme:

1. Bazat e mekanikës për mjetet e transportit, kl. 10 dhe kl.11;
2. Njohuri për mjetet e transportit, kl.10 dhe kl.11;
3. Shërbime mjetesh transporti, kl.10 dhe 11;
4. Elektroteknika dhe elektronika në automjete, kl.10 dhe kl.11;
5. Bazat e sipërmarrjes, kl.12 dhe kl.13;
6. Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm, kl.13;
7. Organizimi dhe ligjshmëria në shërbime mjetesh transporti, kl.13;
8. Diagnostikimi i parregullsive në mjetet e transportit, kl.13;
9. Sistemet moderne në mjetet e transportit, kl.13;

Tabela 1: Lëndët dhe peshat përkatëse në programin orientues

Nr	Lënda	Vëllimi i orëve për çdo lëndë	Peshat në %
1	Bazat e mekanikës për mjetet e transportit	30	10
2	Njohuri për mjetet e transportit	86	27
3	Shërbime mjetesh transporti	75	24
4	Elektroteknika dhe elektronika në automjete	18	6
5	Bazat e sipërmarrjes	19	6
6	Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm	14	4
7	Organizimi dhe ligjshmëria në shërbime mjetesh transporti	6	2
8	Diagnostikimi i parregullsive në mjetet e transportit	46	15
9	Sistemet moderne në mjetet e transportit	20	6
	TOTALI	314	100%

Temat sipas lëndëve janë:

- a) **“Bazat e mekanikës për mjetet e transportit”**, kl.10 dhe kl.11: **(30 orë)**
- Lidhjet e metaleve 2 orë
 - Mekanizmat tipike të makinave 4 orë
 - Transmisionet (sistemet) tipike të makinave. 6 orë
 - Shtypja, tërheqja, përkulja, përdredhja dhe prerja 6 orë
 - Përpunimi me prerje 2 orë
 - Përpunimi me saldim dhe ngjitje 3 orë
 - Përpunimi me heqje ashkle 4 orë
 - Saktësia e punimit. Kuptimi dhe llojet e tolerancave të përmasave. 3 orë
- b) **“Njohuri për mjetet e transportit”**, kl.10 dhe kl.11 **(86 orë)**
- Sistemi i ndezjes së MDB 10 orë
 - Sistemi i ftohjes së MDB 8 orë
 - Sistemi i vajisjes së MDB 8 orë
 - Sistemi i ushqimit me injeksion të benzinës 8 orë
 - Sistemi i ushqimit me injeksion të naftës 8 orë
 - Burimet e energjisë elektrike në mjete transporti 10 orë
 - Sistemi i lëshimit të motorit 6 orë
 - Freksionet e mjeteve të transportit 7 orë
 - Kutitë e shpejtësive në mjetet e transportit 11 orë
 - Sistemet e frenimit të mjeteve të transportit 10 orë
- c) **“Shërbime mjetesh transporti”**, kl.10 dhe 11 **(75 orë)**
- Ndërtimi dhe funksionimi i një servisi automjetesh 4 orë
 - Llojet dhe përshkrimi i dëmtimeve të detaleve dhe nyjeve në makina 6 orë
 - Konsumimi dhe vajisja e detaleve dhe nyjeve të makinave 5 orë
 - Metodat e riparimit të detaleve të makinave 6 orë
 - Punime të zëvendësimit në sistemin e vajisjes së motorit 5 orë
 - Punime të zëvendësimit në sistemin e ftohjes së motorit 4 orë
 - Punime të zëvendësimit në sistemin e ushqimit të motorit 6 orë
 - Punime të zëvendësimit në burimet e energjisë elektrike 4 orë
 - Punime të zëvendësimit në sistemin e ndezjes së motorit 4 orë
 - Punime të zëvendësimit në sistemin e lëshimit të motorit 4 orë
 - Punime të zëvendësimit në sistemet e drejtimit të automjeteve 5 orë
 - Punime të zëvendësimit në sistemet e frenimit të automjeteve 6 orë

- Punime të zëvendësimit në sistemet ndihmëse të automjeteve 5 orë
- d) **“Elektroteknika dhe elektronika në automjete”, kl.10 dhe kl.11 (18 orë)**
- Madhësitë elektrike dhe matja e tyre 3 orë
 - Elementet (simbolet) dhe llojet kryesore të skemave elektrike 6 orë
 - Ndriçuesit dhe sinjalizuesit 4 orë
 - Pajisjet mbrojtëse (siguresat dhe automatët) 3 orë
 - Gjysëmpërçuesit 2 orë
- d) **“Bazat e sipërmarrjes”, kl. 12 dhe 13: (19 orë)**
- Tregu dhe sjellja konsumatore 5 orë
 - Legjislacioni i punës 5 orë
 - Menaxhimi i informacionit 4 orë
 - Menaxhimi i marketingut 5 orë
- e) **“Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm”, kl. 13: (14 orë)**
- Burimet kryesore të mjedisit dhe degradimi mjedisor 3 orë
 - Ndikimi i veprimtarisë së njeriut në mjedis 3 orë
 - Zhvillimet demografike dhe mjedisi 4 orë
 - Shoqëria e konsumit dhe mbetjet 4 orë
- f) **“Organizimi dhe ligjshmëria në shërbime mjetesh transporti, kl.13: (6 orë)**
- Strukturat organizative (organigrama) e një servisi (ndërmarrjeje) për shërbimet e mjeteve të transportit 2 orë
 - Ndërtimi dhe pajisjet kryesore të një servisi tipik për shërbime mjetesh transporti 2 orë
 - Rregullat e sigurisë në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit në shërbimet e mjeteve të transportit 2 orë
- g) **“ Diagnostikimi i parregullsive në mjetet e transportit”, kl.13: (46 orë)**
- Diagnostikimi i parregullsive në sistemet elektrike të automjetit 6 orë
 - Diagnostikimi i parregullsive të mekanizmave dhe sistemeve të motorit 6 orë
 - Diagnostikimi i parregullsive të elementeve të transmisionit të fuqisë në Automjet 10 orë
 - Diagnostikimi i parregullsive të sistemit të frenimit të automjetit 10 orë
 - Diagnostikimi i parregullsive të sistemit të drejtimit të automjetit 6 orë
 - Diagnostikimi i parregullsive të sistemit të ecjes së automjetit 8 orë
- h) **“Sistemet moderne në mjetet e transportit”, kl.13 (20 orë)**
- Klasifikimi i sistemeve moderne në mjetet e transportit 2 orë
 - Sistemet moderne të sigurisë së lëvizjes në mjetet e transportit 10 orë

- Sistemet moderne për mbrojtjen e mjedisit nga efektet negative të mjeteve të transportit 8 orë